



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:039147

Datë: 13.11.2020

Numri i dokumentit: 01269478

**P.nr.739/19**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**, gjyqtari i çështjes Avni Sylja, me Bashkëpunorën Profesionale Bleta Gashi Rrusta, në çështjen penale kundër të akuzuarit L. H., për shkak të veprës penale Vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së, i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr.514/2019 të datës 26.02.2019, në shqyrtimin fillestar të mbajtur me datë 09.11.2020, në prezencën e përfaqësuesit së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Prokurorja e Shtetit Fikrije Sylejmani dhe të akuzuarit L. H., më datë 11.11.2020 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 13.11.2020 përpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

#### **I akuzuari:**

**L. H.**, i biri i B. dhe nënës H. e gjinisë D., i lindur me datë ..... në P., me vendbanim në rrugën ..... në P., i martuar, baba i 2 fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, me gjendje të dobët ekonomike, me nr. personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

### **ËSHTË FAJTOR**

#### **Për shkak se:**

Me datë 06.02.2018 rreth orës 15:00 në rrugën “Stefan Mokranjac” në Prishtinë, në shitoren “.....”, pronë e të dëmtuarit B. D., i pandehuri me dashje dhe me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër ka marrë katër (4) kavanoz me mjaltë ‘Medex’ me peshë prej 900 gram në vlerë prej 60.00 euro, të cilat në hyrje të tregut të gjelbër në Prishtinë i ka shitur NN personave në shumën totale prej dymbëdhjetë (12) euro.

**-Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja nga neni 325 par.1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata konform dispozitave dhe neneve 7, 17, 21, 41, 46, 49, 50, 51, dhe 73 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, e:

### **G J Y K O N**

Të akuzuarin L. H. me dënim me kusht duke i vërtetuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej katër muaj (4) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën verifikuese prej një (1) viti nuk kryen vepër tjetër penale, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 100€ (njëqind euro), nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale - paushallit gjyqësor shumë prej 20€ (njëzetë Euro) si dhe 30€ (tridhjetë Euro) në emër të Fondit për mbrojtjen e viktimave, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar lidhur me realizimin e kërkesës pasurore - juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko - civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.514/2019 të datës 26.02.2019, ka akuzuar L. H., për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 325 par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti shqyrtimin fillestar më dt. 09.11.2020 dhe pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit Fikrije Sylejmani, pasi që i pandehuri L. H. është njoftuar me të drejtat e tij në kuptim të nenit 246 par.1 të KPPK-së dhe pas njoftimit lidhur me pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë, të njëjtit i është ofruar mundësia të pranojë fajësinë ose të deklarohej i pa fajshëm, i pandehuri L. H. është deklaruar se e pranon fajësinë për aktakuzën që i vihet në barrë nga Prokuroria e Shtetit, duke shtuar se veprën të cilën e ka kryer ka qenë edhe përdorues i substancave narkotike dhe i janë nevojitur të hollat për këtë për çka ndien keqardhje për rastin që ka ndodhur dhe pendohet thellësisht për këtë veprë që ka ndodhur, i premtonte gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla penale.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për shkak se pranimi i fajësisë është bërë në përputhje me nenin 248 të KPRK-së, që do të thotë se i pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban shkelje ligjore ose gabime faktike dhe si rrjedhojë i propozon gjykatës që ta pranon fajësinë nga ana e të pandehurit dhe se me rastin e shqiptimit të dënimit gjykata ta marrë parasysh si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë.

Pasi që gjykata konstatoi që i pandehuri pranon në tërësi veprën penale me të cilën është ngarkuar, që i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, që pranimi bëhet vullnetarisht nga i pandehuri, që pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, konform nenit 248 par.4 të KPRK-së, gjyqtari i vetëm gjykues mori aktvendim me të cilin e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasi që vlerësoi se ky pranim ishte në përputhje të plotë edhe me provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës, e që të gjitha këto në mënyrë të plotë dhe të argumentuar e vërtetojnë faktin se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata nuk administroi provat, por vazhdojë me matjen e dënimit.

Gjatë matjes së dënimit të akuzuarit, gjykata i vlerësoi të tëra rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe në lartësinë e dënimit konform nenit 73 të KPRK, andaj gjykata si rrethanë lehtësuese të akuzuarit i mori faktin e pranimit të fajësisë qysh në shqyrtim fillestar, pendimin e thellë për veprën penale të kryer, gjendjen materiale, ndërsa rrethana rënduese për të akuzuarin gjeti rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, andaj të akuzuarit konform nenit 50, 51 dhe nenit 46 të KPRK-së, për veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, i shqipton dënim me kusht duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 1 (një) viti nuk kryen veprë tjetër penale nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 150€, të

cilin dënim obligohet ta paguaj nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, me bindje se dënimet e shqiptuara i përgjigjen shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe do të ndikojnë në risocializimin dhe riedukimin e tij si dhe do të ndikojnë tek të tjerët që mos të kryejnë vepra penale çka është edhe qëllimi i shqiptimit të dënimit me kusht konform nenit 46 dhe 51 të KPRK dhe qëllimi i shqiptimit të dënimeve të përgjithshme i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6, lidhur me nenin 453 par.1 të KPPRK-së.

Vendimi për shumën e të hollave në emër të Fondit për mbrojtjen e viktimave është marrë konform nenit 39 par.3, nënpar.3.1 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P.nr.739/19 të datë 13.11.2020**

**Bashkëpunëtore Profesionale**  
**Bleta Gashi Rrusta**

**G j y q t a r i**  
**Avni Syla**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar Ankesa në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj gjykate.